

Ali Musliu, PhD<sup>1</sup>

UDC: 28-74:172.4  
28-74:355.02

## E DREJTA E JETËS DHE INTEGRITETIT FIZIK

## ПРАВО НА ЖИВОТ И ЛИЧЕН ИНТЕГРИТЕТ

## RIGHT TO LIFE AND PHYSICAL INTEGRITY

### Abstract

The right to life is a fundamental and most vital human right; it represents the most precious value for an individual and society in general. In failing to protect the right to life all other rights risk losing their meaning. This paper defines the existence of inherent and natural human rights where the right to life is an innate right and therefore requires no need for special recognition of the positive law. On the other hand, the protection of physical integrity, i.e. protection from torture, ill-treatment or punishment, inhuman or degrading treatment is essential for the implementation of human rights standards. Together with the right to life it forms the essential elements for guaranteeing human dignity. The paper examines and analyzes these two rights in close connection with each other in the Republic of North Macedonia. In addition, the paper treats legal institutions, such as euthanasia, the issue of abortion, and the death penalty, from the perspective of the European Convention on Human Rights.

**Keywords:** *Human Rights, Physical Integrity, Constitution, European Convention on Human Rights*

---

<sup>1</sup> Profesor në Universitetin e Tetovës - Fakulteti Juridik, Maqedoni, Tetovë. Email: ali.musliu@unite.edu.mk

## 1. E drejta e jetës si e drejtë themelore

E drejta e jetës, është e drejtë themelore e njeriut, sepse, pa respektimin e kësaj të drejte, nuk mund të paramendohen të drejtat tjera të njeriut. E drejta për jetuar është një e drejtë thelbësore dhe e pashmangshme. Të drejtës për jetuar i jepet një rëndësi e veçantë në të drejtën ndërkombëtare sepse të drejtat e tjera nuk do të kishin asnjë kuptim në mungesë të jetës. Kjo nuk do të thotë se e drejta e jetës është me e rëndësishmja, në kuptimin që të gjitha të drejtat e tjera janë të një rëndësie më të ulët apo më pak të mbrojtura. Kjo do të thotë se rëndësia e të drejtës së jetës është njohur si vlerë që përmban në vetvete qenia njerëzore. Në këtë kuptim, e drejta për jetën lidhet ngushtësisht me dinjitetin njerëzor. E drejta e jetës mbrohet me nenin 6 të Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politik<sup>2</sup>, si dhe në veçanti neni 2 i Konventës Evropiane për Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut. Konventa Evropiane për të Drejta dhe Liritë Themelore të Njeriut, në nenin 2 të saj thekson se: “E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t’i merret jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj. Marrja e jetës nuk konsiderohet të jetë shkaktuar në kundërshtim me këtë nen në rastet kur ajo

<sup>2</sup> PAKTI NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE, Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 2200 A (XXI) të datës 16 dhjetor 1966, HYRË NË FUQI: 23 mars 1976. Neni 6 thekson:

1. E drejta e jetës është e drejtë e lindur e njeriut. Kjo e drejtë duhet të mbrohet me ligj. Askush nuk mund të privohet arbitrarisht nga jeta.
2. Në vendet ku nuk është hequr dënimi me vdekje, ai mund të jepet vetëm për krimet më të rënda, në përputhje me ligjin në fuqi në kohën e kryerjes së krimit dhe nuk duhet të jetë në kundërshtim me dispozitat e këtij Pakti dhe me Konventën për Parandalimin dhe Ndjekjen e Krimit të Gjenocidit. Ky dënim mund të jepet vetëm në bazë të një gjykimi përfundimtar nga një gjykatë kompetente.
3. Kur heqja e jetës përbën një krim gjenocidi, kuptohet se asnjë dispozitë e këtij neni nuk i jep të drejtë një shteti palë të këtij Pakti që në asnjë mënyrë t’i shmanget çfarëdo detyrimi që ka marrë përsipër në bazë të dispozitave të Konventës për Parandalimin dhe Ndjekjen e Krimit të Gjenocidit.
4. Çdo i dënuar me vdekje ka të drejtë të kërkojë falje ose zëvendësim të dënimit. Amnistia, falja ose zëvendësimi i dënimit me vdekje mund të jepen në të gjitha rastet.
5. Dënimi me vdekje nuk mund të jepet për krimet e kryera nga personat nën 18 vjeç dhe nuk mund të zbatohet ndaj grave shtatzëna.
6. Asnjë dispozitë e këtij neni nuk mund të shfrytëzohet për të vonuar ose për të ndaluar heqjen e dënimit kapital nga një shtet palë i këtij Pakti.

vjen si pasojë e përdorimit të forcës, që është jo më shumë se absolutisht e nevojshme: a. në mbrojtje të çdo personi nga dhuna e paligjshme; b. për të kryer një arrestim të ligjshëm ose për të parandaluar arratisjen e një personi të cilit i është hequr liria ligjërisht; c. për të kundërshtuar, në përputhje me ligjin, një trazirë ose kryengritje.<sup>3</sup>

### 1.1. Dënimi me vdekje

Dënimi me vdekje është një ndër çështjet më të diskutuara lidhur me të drejtat e njeriut, respektivisht me të drejtën e jetës. Dënimi me vdekje, si një dënim penal i zbatueshëm për vepra penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore, i cili është zbatuar dhe zbatohet ende në pjesën më të madhe të vendeve të botës<sup>4</sup>, si dënim më ekstrem penal që synon eliminimin përfundimtarë të një personi i cili mendohet të jetë i parahabilitueshëm dhe që ka cenuar rëndë interesat e mbrojtura nga shoqëria. Ky dënim pa dyshim që përbën një dhunim të dukshëm të së drejtës së jetës dhe pavarësisht nga diskutimet e shumta që përpiqen që justifikojnë zbatimin e tij ndaj personave që kanë marrë jetën të tjerëve, përsëri ai mbetet i pajustificuar.

Shumë traktate të të drejtave të njeriut kanë parashikuar heqjen e dënimit me vdekje, dhe edhe nëse ky dënim nuk ndalohet nga vetë traktati, do të jetë i dëshirueshëm të mos zbatohet.<sup>5</sup> Nëse dënimi me vdekje nuk është hequr, duhet të zbatohen disa detyrime të caktuara:

- a. Dënimi duhet të caktohet në përputhje me ligjin në fuqi në kohën kur është kryer krimi.<sup>6</sup>
- b. Dënimi duhet të caktohet nga një gjykatë kompetente.
- c. Kërkohej që shtetet ta kufizojnë atë vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe vetëm për krime të rënda.<sup>7</sup> Në Komentin e tij të

<sup>3</sup> Konventa Evropiane për të Drejta dhe Liritë Themelore të Njeriut e miratuar në Romë më 04.10.1950, si dhe plotësuar me Protokollin bazë: shoqëruar nga Protokollin Nr. 1, 4, 6, 7, 12 e 13 dhe ndryshuar me Protokollin Nr. 11 dhe 14.

<sup>4</sup> Për shkak të faktit se shumë shtete e kanë të sanksionuar dënimin me vdekje (vetëm 140 shtete e kanë shfuqizuar atë; në vitin 2014 janë kryer ekzekutime në 22 shtete<sup>4</sup>), dënimi me vdekje nuk është hequr. Për shembull, PNDCP e ka ruajtur këtë përjashtim të së drejtës për të jetuar (megjithëse, Protokollin i Dytë Opsional që ndalon dënimin me vdekje është ratifikuar nga 80 shtete palë, Amnesty International, *Death Sentences and Executions, 2014*, f.5).

<sup>5</sup> Shih Komitetin Evropian i të Drejtave të Njeriut, Koment i Përgjithshëm Nr. 6, UN Doc.HRI/GEN/1/Rev.6, (2003) paragrafi 6

<sup>6</sup> Shih parimin e fuqisë retroaktive/jo-prapavepruese, në kapitullin mbi të drejtat e njeriut.

<sup>7</sup> Për shembull: Neni 6(2) i KNDPCP; Komenti i Përgjithshëm Nr. 6, paragrafi 7.

Përgjithshëm Nr. 6, Komiteti i të Drejtave të Njeriut ka theksuar se togfjalëshi 'krime më të rënda' duhet të interpretohet 'në mënyrë të kufizuar'. Krimet për të cilat do të zbatohet dënimi me vdekje nuk duhet të jenë përcaktuar në mënyrë të paqartë.<sup>8</sup>

c. Procesi që vendos dënimin me vdekje duhet të jetë i drejtë dhe në përputhje me dispozitat e traktatit përkatës; kjo nuk do të cenojë vetëm të drejtën për të jetuar por edhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor.<sup>9</sup>

d. Dënimi me vdekje duhet ekzekutohet 'në mënyrë të tillë që të shkaktojë sa më pak të jetë e mundur, vuajtje fizike dhe mendore'.<sup>10</sup>

e. Dënimi me vdekje nuk duhet të zbatohet ndaj të miturve.<sup>11</sup>

f. Personat e dënuar me vdekje kanë të drejtë të kërkojnë faljen apo uljen e dënimit.<sup>12</sup>

Në vendet ku ekziston dënimi me vdekje, Shteteve u kërkohet të kryejnë kontrole periodike dhe të pavarura për të vlerësuar zbatimin e normave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe të lejojnë mbledhjen e provave që mund të provojnë pafajësinë e të akuzuarit.<sup>13</sup> Nëse Shtetet e kanë hequr dënimin me vdekje, nuk mund ta rivendosin më atë.<sup>14</sup> Dënimet me vdekje nuk janë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.<sup>15</sup> Si pasojë, 'dënimi me vdekje për krimin e vrasjes në përgjithësi, pa mbajtur parasysh rrethanat përkatëse të të

<sup>8</sup> Vërejtje Përmblyëse: Vietnam, O.K.B. Doc.CCPR/CO/75/VNM (2002), para.7. Po ashtu, Siria, O.K.B Doc.CCPR/CO/71/SYR (2001), para.9 dhe Togo, O.K.B Doc.CCPR/CO/76/TGO (2002), para.10

<sup>9</sup> Komenti i Përgjithshëm i Komitetit të të Drejtave të Njeriut Nr. 32, UN Doc.CCPR/C/GC/32 (2007), para.59. Shih *Tibi v Ekuadorit* (Gjykata Ndër-Amerikane); shih, gjithashtu, *Maritza Urrutia v Guatemalës* (Gjykata Ndër-Amerikane); *Cantoral-Benavides k Perusë* (Gjykata Ndër-Amerikane); Komenti i Përgjithshëm Nr.6 i Komitetit të të Drejtave të Njeriut, HRI/GEN/1/Rev.6 at 127 (2003), para.16; *McLawrence v Xhamajkës* (Komiteti i të Drejtave të Njeriut)

<sup>10</sup> *Kindler v Kanadasë* (Komiteti i të Drejtave të Njeriut)

<sup>11</sup> Raporti i Raportuesit Special për Ekzekutimet Ekstra-gjyqësore, të Jashtëzakonshme ose Arbitrare (2009), O.K.B Doc.A/HRC/11/2, parag .29-42

<sup>12</sup> Raporti i Raportuesit Special për Ekzekutimet Ekstra-gjyqësore, të Jashtëzakonshme ose Arbitrare, O.K.B Doc.A/HRC/8/3, para. 59-67

<sup>13</sup> Raporti i Raportuesit Special për Ekzekutimet Ekstragjyqësore, të Jashtëzakonshme ose Arbitrare (2005), UN Doc.E/CN.4/2005/7, parag.61

<sup>14</sup> Shih për shembull, *Judge v Kanadasë* (Komiteti i të Drejtave të Njeriut)

<sup>15</sup> *Boyce dhe Joseph v Mbretëreshës* (Këshilli Kofidencial), parag. 6. Shih gjithashtu Raportuesin Special për Ekzekutimet Ekstra-gjyqësore, të Jashtëzakonshme ose Arbitrare (2005), O.K.B. Doc.E/CN.4/2005/7, parag.63

pandehurit apo rrethanat konkrete në të cilat është kryer krimi', shkel të drejtën për të jetuar.<sup>16</sup>

Raportuesi Special për ekzekutimet ekstra-gjyqësore ka theksuar se paaftësia e Shteteve për të dhënë informacion mbi dënimin me vdekje do të përbëjë shkelje të normave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, përfshirë këtu edhe 'raportimin e plotë dhe të saktë' të rasteve kur është përdorur dënimi me vdekje.<sup>17</sup>

Në kuadër të Këshillit të Evropës, ku Republika e Maqedonisë së Veriut është anëtare, konform Konventës Evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, dënimi me vdekje tashmë është një dënim i paligjshëm. E drejta për të jetuar e garantuar nga Neni 2(1) i KEDNJ parashikon rrethanat kur me mund të lejohet dënimi me vdekje. Protokollin 6 i KEDNJ heq dënimin me vdekje përveç akteve të kryera në kohë lufte. Protokollin 13 shkon më tej dhe shfuqizon dënimin me vdekje në çdo rrethanë.<sup>18</sup> Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut tashmë ka vendosur se fjalia e dytë e Nenit 2(1) nuk e ka ndaluar Gjykatën që të konstatojë se dënimi me vdekje përbën trajtim çnjerëzor dhe poshtëruar.<sup>19</sup> Në vitin 2014, Gjykata bëri disa deklaratatë të forta për dënimin me vdekje, duke përcaktuar faktin se 'çaktimi dhe përdorimi i dënimit me vdekje mohon të drejtat themelore të njeriut të njohura nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës' dhe që zbatimi gjyqësor i këtij dënimi ishte 'shkatërrim i qëllimshëm dhe i paramenduar i një qenieje njerëzore nga autoritetet e Shtetit'.<sup>20</sup> Në vitin 2015, Gjykata përcaktoi se 'dënimi me vdekje konsiderohet një formë e papranueshme dënimi që nuk më lejohet nga Neni 2, i ndryshuar nga Protokollin 6 dhe 13, dhe përbën gjithashtu trajtim apo dënim çnjerëzor dhe poshtëruar'.<sup>21</sup> Kjo gjë u aplikua edhe ndaj Rusisë, ndonëse nuk kishte ratifikuar as Protokollin 6 dhe as Protokollin 13.

E drejta për të jetuar njih disa raste të përcaktuara në mënyrë specifike të kufizimit të së drejtës së jetës. Këto raste të kufizimit të së

<sup>16</sup> *Thompson (Eversley) v Shën Vinsent dhe Greolandës* (Komiteti i të Drejtave të Njeriut) parag.8.2

<sup>17</sup> Raportuesi Special për Ekzekutimet Ekstragjyqësore, të Jashtëzakonshme ose Arbitrare (2005), OKB Doc.E/CN.4/2005/7, paragrafi 57 dhe 59.

<sup>18</sup> Shih në: Brownlie, I. (2009). *Basic Documents in International Law*. Oxford University Press;

<sup>19</sup> *Gomien, D. (2005). Udhëzues i shkurtër u Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Këshilli i Evropës*. Gent Grafik. Tiranë, f. 20.

<sup>20</sup> Ibidem, f. 21.

<sup>21</sup> Ibidem, f. 22.

drejtës së jetës do të shpjegohen me hollësi me poshtë. Është e rëndësishme të theksojmë se agjencitë e zbatimit të ligjit duhet të kuptojnë rastet e kufizuara në të cilat lejohet përdorimi i forcës vdekjeprurëse. Këto raste mund të jenë të tilla si: Vetëmbrojtja; Arrestimi; Parandalimi i arratisjes; dhe Zmbrapsja e kryengritjeve apo trazirave.

Rastet e mësipërme përjashtimore në të cilat lejohet marrja e jetës janë përcaktuar shprehimisht nga KEDNJ si dhe janë gjithëpranuar nga e drejta e brendshme e shteteve. Megjithatë, këto përjashtime i nënshtrohen testit që lidhet me nevojën absolute, që ndërhyrja të jetë 'absolutisht e nevojshme', që i shtohet testit të proporcionalitetit. Në rastin e zbatimit të një arrestimi të ligjshëm, përdorimi vdekjeprurës i forcës lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme. Kjo do të thotë se, thjesht fakti që dikush kundërshton arrestimin, qoftë edhe kur dyshohet për një veprë penale të rëndë, nuk justifikon marrjen e jetës duke përdorur forcë vdekjeprurëse, përveç rastit kur personi në fjalë kundërshton arrestimin me një forcë të tillë sa mund t'u shkaktojë vdekjen të tjerëve. Ky parim duhet të zbatohet në mënyrë të njëjtë edhe ndaj atyre që marrin pjesë në një kryengritje. Si rregull, shkaktimi i vdekjes është një veprim i paligjshëm përveç rastit kur kryhet për vetëmbrojtje ose për mbrojtjen e të tjerëve të cilët potencialisht mund të jenë subjekt të forcës vdekjeprurëse të ushtruar ndaj tyre. Në rrethana të tilla, kur ekziston një rrezik i tillë atëherë mund të përdoret forca si mjet i fundit. Kufizimet e lejuara rregullohen edhe nga rregullat shtesë të Kodit të Sjelljes të OKB për Zyrtarët që Zbatojnë Ligjin. Në një rast, përdorimi i armës së zjarrit nga një oficer policie nuk u konsiderua si 'domosdoshmërisht i nevojshëm', për rrjedhojë gjykata kombëtare që liroi oficerin në fjalë u gjet në shkelje të Konventës.<sup>22</sup>

E drejta për të jetuar, qartësisht u imponon shteteve detyrimin negativ për të kufizuar marrjen e jetës. Çdo vdekje e shkaktuar nga ndonjë agjent i Shtetit kur përdorimi i forcës nuk ka qenë absolutisht i nevojshëm apo për arsye të ndryshme nga sa janë përcaktuar më sipër, do të sillte cenim të së drejtës për të jetuar dhe do të ishte e paligjshme. Duhet të theksohet se e drejta për të jetuar nuk ka të bëjë vetëm me vrasjet me dashje, por mund të cenohet edhe në rastin kur nga përdorimi i forcës se lejuar mund të rezultojë, si një rezultat i padëshiruar, marrja e jetës.<sup>23</sup>

<sup>22</sup> Më shumë shih në: Daci, J. (2011). Të drejtat e njeriut. Botimi III. Shtëpia botuese Julvin. Tiranë, f. 245-251

<sup>23</sup> Më shumë shih në: Slyne fon. (2016). Zbatimi i të drejtave të njeriut në praktikë. Londër, UK, f. 91-101.

E drejta për të jetuar nuk kërkon domosdoshmërisht një vdekje - ajo gjen zbatim edhe 'kur rrethanat e çështjes apo natyra e dëmtimeve të shkaktuara tregojnë se jeta e ankuesit ishte në rrezik serioz', megjithatë kjo do të zbatohet vetëm në rrethana përjashtimore dhe normalisht do të trajtohet sipas Neni 3. Përgjithësisht çështje si, 'cilësia e jetës' nuk përcaktohen nga Neni 2, por rregullohen nga Neni 8. Neni 2 është zbatuar ndaj një të burgosuri i cili ishte i infektuar me HIV, dhe në rastin e një hetimi të gjatë dhe aspak efektiv të një aksidenti rrugor, si pasojë e të cilit ankuesi kishte qenë në koma për shumë vite.

Në rast se pretendohet se humbja e jetës është shkaktuar nga një agjent i Shtetit, GJEDNJ ka përcaktuar se ky fakt duhet të provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, i cili mund të vijë si rrjedhojë e konkluzioneve mjaftueshëm të forta, të qarta dhe që përputhen me njëri-tjetrin apo nga prezumime fakti të ngjashme dhe të provuara'. Megjithatë, kur një individ vdes në burg dhe Shteti dështon të japë një shkak të besueshëm për vdekjen e tij, në mungesë të provave të tjera, konkluzioni mund të jetë që vdekja është shkaktuar nga veprimet apo mosveprimet e autoriteteve shtetërore. Në rrethana të tilla, cenimi i të drejtës për të jetuar mund të provohet vetëm nga indiciet dhe nga konkluzione të forta dhe të qarta. Kjo përjasje mund të zbatohet gjithashtu edhe rastet e zhdukjeve, të cilat do të shpjegohen me poshtë.<sup>24</sup>

Për sa i përket barrës së provës, në rastin kur një person vdes në burg, shteti ka barrën e provës për të përcaktuar shkakun e vdekjes. Po ashtu, kur një vdekje rezulton nga përdorimi i forcës nga një shteti, shteti ka detyrimin të provojë se përdorimi i forcës ishte absolutisht i domosdoshëm.<sup>25</sup> Nëse shteti dështon të japë një shpjegim të besueshëm, cenimi i së drejtës për të jetuar mund të provohet pa qenë nevoja për prova të tjera. Në rastin kur vdekja ndodh kur personi nuk është në burg apo si rezultat i përdorimit të forcës nga Shteti, barra e provës nuk i përket asnjërës palë.

Gjykata ka trajtuar në mënyrë specifike këtë çështje. Shtetet duhet të kenë përcaktuar/miratuar një 'kuadër të përshtatshëm ligjor dhe administrativ që përcakton, në përputhje me standardet kryesore ndërkom-bëtare, rrethanat e kufizuara në të cilat oficerëve të zbatimit të ligjit (policëve) u lejohet të përdorin forcën dhe armët e zjarrit'. Gjykata ka pranuar Parimet Bazë të OKB mbi Përdorimin e Forcës dhe Armëve të Zjarrit nga Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit, që kërkon *inter alia* se:

<sup>24</sup> Slyne fon. (2016). Zbatimi i të drejtave të njeriut në praktikë. Londër, UK, f. 91

<sup>25</sup> Ibidem, f. 95.

- a. Lejohet përdorimi i armëve të zjarrit vetëm në rast se përdorimi i mjeteve më të buta është i pamjaftueshëm për të arritur qëllimin e kërkuar, dhe kur është e jashtëzakonisht e paevitueshme mbrojtja e jetës;
- b. Të veprohet në proporcion me rëndësinë e shkeljes dhe për arritjen e një qëllimi të ligjshëm;
- c. Të prodhohen armë që nuk kanë aftësi vdekjeprurëse, për t'u përdorur në rrethana të përshtatshme; dhe
- d. Arbitrariteti dhe përdorimi abuziv i forcës të dënohen si vepra penale.<sup>26</sup>

Gjykata ka theksuar se kërkohet përdorimi i të shtënave paralajmëruese, të cilat duhet të kryhen sa 'herë që të jetë e mundur'. Përdorimi i papërshtatshëm i armëve jovdekjeprurëse, si për shembull Taserat, megjithëse nuk ngre çështje që përfshihen në nenin 2, mund të përbëjë shkelje të Nenit 3.<sup>27</sup> Edhe në situata të cilat mund të klasifikohen si konflikt i armatosur, e drejta për të jetuar mbetet e rëndësishme. Dështimi për të hetuar në mënyrë të përshtatshme humbjen e jetës shkel të drejtën për të jetuar nëse njerëzit vriten nga forcat e armatosura në përpjekje për të shtypur një kryengritje të armatosur. Nuk është e mjaftueshme të deklarohet se humbja e jetës ishte pasojë legjitime e luftimeve.

## 1.2. Aborti dhe eutanazia

Ndër të drejta për jetën një nga çështjet më të diskutueshme janë ato të abortit dhe eutanazisë.<sup>28</sup> Aborti (abortus) paraqet ndërprerje të dhunshme të shtatzënisë me flijimin e frytit (fetusit) si të tillë. Qëllimi i vendimit për lejimin ligjor për ndërprerjen e shtatzënisë bëhet për shkaqe shëndetësore dhe të largimit të rrezikshmërisë së jetës së femrës, shteti duke siguruar jetën e femrës në rrugë institucionale dhe larguar nga format me të vrazhda dhe jo mjekësore jashtë institucionale që kanë sjellë edhe pasoja fatale-vdekjen. Shtetet vendosën që të marrin masa për mbrojtjen institucionale për të larguar femrën nga rreziku i rritjes së morbiditetit dhe mortalitetit të saj si pasojë e bërjes së aborteve ilegale.<sup>29</sup>

<sup>26</sup> Slyne fon. (2016). Zbatimi i të drejtave të njeriut në praktikë. Londër, UK, shih Paragrafi 7 *Finogenov vs. Ruisë*

<sup>27</sup> Slyne fon. (2016). Zbatimi i të drejtave të njeriut në praktikë. Londër, UK, shih *Anzhelo Georgiev v Bullgarisë*

<sup>28</sup> Termi eutanazi në terminologjinë profesionale në gjuhën shqipe përdoret si: vrasja e mëshirshme; vdekja e mëshirshme; vdekje e ëmbël, etj.

<sup>29</sup> Shih për shembull Nenin (1) i Ligjit për ndërprerjen e shtatzënisë, Ligji Nr. 03/L-110 Shpallur më Vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 03-V-081, datë 22 janar 2009.



Sipas Ligjit për ndërprerjen e shtatzënisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, çdo femër e moshës mbi tetëmbëdhjetë (18) vjeç ka të drejtë që të kërkoj ndërprerjen elektive të shtatzënisë. Femrat që kanë arritur moshën e rritur prej gjashtëmbëdhjetë (16) vjetësh dhe kanë marrë pëlqimin e prindit ose të kujdestarit ligjor kanë të drejtë të kërkojnë ndërprerjen e shtatzënisë.<sup>30</sup> Ndërprerja elektive e shtatzënisë mund të bëhet deri në fund të javës së dhjetë (10) të shtatzënisë duke llogaritur nga dita e parë e ciklit të fundit menstrual.<sup>31</sup> Çdo ndërprerje e shtatzënisë pas javës së dhjetë (10) është në kundërshtim me Ligjin e Shëndetësisë dhe duhet të bëhet me komision shëndetësor profesional.

Ndërprerja e shtatzënisë bëhet vetëm në institucionet shëndetësore nga mjekët specialist obstetër-gjinekolog të licencuar. Ndërprerja e shtatzënisë për arsye mjekësore në rastet ku konstatohet se vazhdimi i shtatzënisë, ose lindja e fëmijës rrezikon jetën ose shëndetin e femrës mund të bëhet në çdo periudhë të shtatzënisë, me vendimin e Komisionit mjekësor dhe pëlqimin e femrës shtatzëne përderisa ajo është e vetëdijshme. Ndërprerja e shtatzënisë për arsye mjekësore kur vërtetohet se fetusi ka keq formime të papajtueshme me jetën, sëmundje ose gjendje të rënda që lënë invaliditet të rëndë dhe kanë trajtim të pasigurt, mund të bëhet në çdo kohë pas rekomandimit dhe vendimit të Komisionit mjekësor për ndërprerjen e shtatzënisë dhe pëlqimin e pacientes përderisa ajo është e vetëdijshme.<sup>32</sup>

Ndërprerja e shtatzënisë për arsye kriminologjike mund të bëhet gjerë në javën e njëzet e dytë (22) të shtatzënisë dhe lindja e indukuar edhe më vonë me rekomandim mjekësor dhe pas konfirmimit nga institucionet kompetente të cilat janë të autorizuar të përcaktojnë nëse shtatzënia është pasojë prej njëres nga veprat penale në vijim: dhunimit; marrëdhënieve të padëshiruara të femrave të cilat janë viktimat të trafikimit dhe shfrytëzimit seksual të detyruar marrëdhënies seksuale me të mitur ose incestit.<sup>33</sup>

Sa i takon eutanazisë (vrasja e mëshirshme), ngre një sërë pyetjesh të vështira të cilat edhe mbivendosen me njëra tjetrën. Mbi

<sup>30</sup> Shih më tepër: Ligji për ndërprerjen e shtatzënisë së Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare RM nr. 87 nga viti 2013.

<sup>31</sup> Ibidem, Neni (3).

<sup>32</sup> Kjo rregullativë ligjore është e njëjtë si në R. Maqedonisë dhe atë të Kosovës. Në Republikën e Shqipërisë disa faza juridike të procesit të abortit nuk janë të ngritura në nivel ligjor por rregullohen me akte nënligjore.

<sup>33</sup> Shih nenin 4 ë Ligjit të për ndërprerjen e shtatzënisë së Republikës së Maqedonisë

eutanazinë janë shfaqur ide dhe janë hedhur teza nëse realisht e njëjta është një “vdekje e mirë”, siç thonë mbështetësit e të kësaj teze, apo “një vrasje e mirë”, siç kundërpërgjigjen kundërshtarët e saj. Fakti që nga prilli i vitit 2002 në Holandë dhe në disa vende perëndimore në Evropë, si dhe disa shtete në SHBA<sup>34</sup> e kanë ligjësuar eutanazinë për t’u zbatuar në rastet kur ajo kërkohet. Kjo ka hapur një debat të gjerë në disa vende të Evropës dhe në SHBA.<sup>35</sup> Në Republikën e Maqedonisë së Veriut një akt i tillë është i kundërligjshëm, ku sipas të Kodit Penal të RMV konsiderohet vepër penale.

Eutanazia ka një histori shumë shekullore dhe nuk është një koncept bashkëkohor, i imponuar prej jetës moderne. Ekziston mendimi se akti eutanazik ka lindur në shekullin e modernitetit, si pjesë e ekstravagancës së mendimit e të jetesës së njeriut. E vërteta është se eutanazia ka filluar të përbëjë shqetësim në dhjetëvjeçarët e fundit dhe vende të ndryshme Evropiane po tentojnë ta depenalizojnë atë ose ta ligjërojnë në kuptimin e plotë të fjalës. Eutanazia është një fenomen mjaftë evidentë në jetën tonë të përditshme. Kemi raste kur një pacient në koma mund t’i shkëputet ushqimi apo frymëmarrja artificiale, t’i hiqet kontrolli me aparatura me anë të aprovimit të familjarëve, duke i sjellë kështu vdekjen, pavarësisht se për këtë nuk ka rregullim ligjor. Kjo nuk është gjë tjetër, veçse një formë eutanazie e paligjshme. Nuk është, gjithashtu, çudi që një pacient i prekur nga një sëmundje e pashërueshme të refuzojë trajtimin. Në një rast të tillë, mjeku është i detyruar t’i bindet pacientit të tij dhe, rrjedhimisht, shkaktohet një eutanazi pasive.

Eutanazia është, në thelb, një akt i kryer me qëllim për të përshpejtuar vdekjen për ata të sëmurë të pashërueshëm që vuajnë nga dhimbje të mëdha e të pakontrollueshme, fizike dhe psikologjike, të cilët e kërkojnë aktin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe me vullnet të plotë në mënyrë të përsëritur e të qartë. Që akti eutanazik të aprovohet, duhet plotësuar një numër i madh kërkesash. Ndër to mund të përmendim faktin që i sëmuri duhet ta shqiptojë kërkesën e tij në mënyrë të përsëritur dhe me shkrim, të jetë shuar çdo dyshim mbi mungesën e aftësisë së tij për të menduar, mjeku ndjekës të jetë konsultuar me një mjek të dytë për të marrë opinionin e tij mbi situatën shëndetësore, të jetë shuar

<sup>34</sup> Eutanazia është e ligjësuar në këto shtete të SHBA-së: Washington DC, California, Colorado, Oregon, Vermont, dhe shtetin e Washington-it

<sup>35</sup> Për më tepër mbi diskursin e jetë dhe të drejtës së eutanazisë në trevat shqiptare shih në: Sinani, D. (2012). *Përkufizimi juridik i vdekjes. Eutanazia*. Shtëpia botuese Naimi, Tiranë.

çdo dyshim mbi raste depresioni mbi pacientin etj. Nga kjo kuptojmë se që të arrish një akt eutanazik nuk është diçka e thjeshtë dhe lehtësisht e arritshme për çdo lloj sëmundjeje dhe, rrjedhimisht, rrudhet ankthi që vjen nga ideja e abuzimit me ligjshmërinë e eutanazisë.<sup>36</sup>

## **2. Ndalimi i torturës, trajtimit çnjerëzor, degradues ose dënimi tjetër mizor**

Ndalimi i torturës trajtohet si një normë absolute e të drejtës ndërkombëtare (*jus cogens*) dhe është një e drejtë e paderogueshme. Kjo do të thotë se asaj i është dhënë statusi më i lartë ligjor në të drejtën ndërkombëtare dhe ndalimi i torturës është një parim universal. Mbrojta nga tortura në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut është një rregull i padiskutueshëm. Në nivelin e OKB dhe Këshillit të Evropës ka traktate specifike që garantojnë mbrojtjen nga tortura (siç është Konventa kundër Torturës). Po ashtu, siç përcaktohet nga Gjykata Ndërkombëtare Penale, tortura e kryer si pjesë e një sulmi të gjerë dhe sistematik kundër civilëve përbën krim kundër njerëzimit.<sup>37</sup>

Mbrojta nga tortura, trajtimi ose dënimi, çnjerëzor apo poshtërues është thelbësor për zbatimin e standardeve të të drejtave të njeriut. Së bashku me të drejtën për të jetuar ajo formon elementët thelbësorë për garantimin e dinjitetit njerëzor. Kështu, nuk mund të justifikohet tortura, trajtimi ose dënimi çnjerëzor dhe poshtërues - edhe në kohë lufte apo emergjence kombëtare. Ndalimi i torturës është një e drejtë absolute dhe është njohur si e tillë nga KEDNJ.

Ka shumë përkufizime të aktit të torturës, por përkufizimi i cili ka shërbyer si bazë për legjislacionin ndërkombëtarë është neni 1 i Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimeve a Dënimeve tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese<sup>38</sup> si vijo: Termi “torturë” nënkupton çdo veprim me të cilin personit tjetër i shkaktohen qëllimisht dhembje a vuajtje të rënda, fizike ose mendore, me qëllim që të sigurojë nga ai ose nga ndonjë person i tretë, informacione ose pohime për ta dënuar për

<sup>36</sup> Për më tepër lidhur me rregullativën ligjore të eutanazisë në ligjin belg, holandez, luksemburges, shih në: Sinani, D. (2012). *Përkufizimi juridik i vdekjes. Eutanazia*. Shtëpia botuese Naimi, Tiranë.

<sup>37</sup> Statuti i Romës i Gjykatës Ndërkombëtare Penale, Neni 7

<sup>38</sup> Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 39/46 të datës 10 dhjetor 1984 HYRË NË FUQI: më 26 qershor 1987 në përputhje me nenin 27 (1)

veprën të cilën ai ose ndonjë person i tretë e ka kryer ose dyshohet se e ka kryer, ose me qëllim që të frikësohet ose detyrohet ai ose ndonjë person i tretë, ose për ndonjë arsye tjetër të bazuar në diskriminimin e cilitdo lloji, kur dhembjet ose vuajtjet e tilla shkaktohen nga një person zyrtar ose nga një person i tretë që vepron sipas detyrës zyrtare ose me nxitjen a pëlqimin e tij. Ky term nuk përfshin vuajtjet ose dhembjet që rezultojnë vetëm nga sanksionet ligjore, që u përkasin ose janë shkaktuar prej tyre.<sup>39</sup>

Organet ndërkombëtare, kryesisht ato gjyqësore, e kanë konkretizuar përkufizimin e saj në praktikë. Praktika tregon forma nga më të ndryshmet nëpërmjet të cilave është ushtruar tortura si ato të burgut Abu Graib në Irak, zhveshja lakuriq për një kohë të gjatë dhe me krahë të lidhur prapa shpine, varja me kokë poshtë, përdhunimet e vazhdueshme në hapësirat e paraburgimit, mbytja me ujë si teknikë hetimi, futja nga uji i ftohët në ujë të nxehtë, vendosja e vezëve të nxehta nën sqetulla, futja e gjilpërave ndërmjet thonjve, djegia me cigare, shoku elektrik, përdorimi i mjeteve të tjera që shkaktojnë vuajtje ekstreme tek viktima etj., si dhe forma psikologjike duke kërcënuar për vrasje e anëtarëve të familjes etj. Dallimi midis trajtimit ose dënimit çnjerëzor, bëhet në rastet konkrete në varësi të rrethanave specifike të rastit.<sup>40</sup>

Veprimet që përbëjnë torturë, trajtim dhe dënim mizor, çnjerëzor dhe denigrues, janë të ndaluara në çdo lloj rrethana dhe nuk justifikohen nga asnjë arsye, qoftë në emër të luftës kundër terrorizmit, pasi, detyrimi i shteteve për të respektuar këtë të drejtë, është i paderogueshëm. Konventa Evropiane në nenin 3 përcakton ndalimin e torturës: “Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese”.<sup>41</sup> Gjykata Evropiane në rastin “Peers kundër Greqisë”, ka theksuar që mbajtja për të paktën 2 muaj në një qeli shumë të vogël e të pa ajrosur, pa banjë, të mbipopulluar, të pistë dhe pa kushte minimale sanitare si trajtim çnjerëzor dhe degradues. Në rastin “Dybe-ku kundër Shqipërisë”, Gjykata unanimisht ka argumentuar që edhe mbajtja e një dënuari me çrregullim kronik mendor, që përfshinte edhe rastin e paranojës cili ishte trajtuar për të njëjtën sëmundje për vite me

<sup>39</sup> Teksti integral në dispozicion: Brownlie, I. (2009). *Basic Documents in International Law*. Oxford University Press;

<sup>40</sup> Gomien, D. (2005). Udhëzues i shkurtër i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Këshilli i Evropës. Gent Grafik. Tiranë, f. 21.

<sup>41</sup> Teksti integral i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në dispozicion: Brownlie, I. (2009). *Basic Documents in International Law*. Oxford University Press;

radhë në spitale psikiatrike si dhe mos mundësimi i kujdesit të nevojshëm mjekësor, sipas rregullave të njohura të shkencës mjekësore, ndaj një personi të paaftë për të vendosur për vetën e tij dhe duke mos pranuar kërkesat e mbrojtësit dhe familjare të ankuesit për riekspertim mjekësor të shëndetit të tij ka shkelur nenin 3 të KEDNJ, duke u barazuar këtë situatë me atë të trajtimit çnjerëzor dhe degraduese.

Shembujt e dhënë më sipër, janë vetëm një pjesë e vogël e formave të torturës, trajtimit çnjerëzorë, degradues apo dënimi mizorë që hasen në jetën e përditshme në shumë vendet e botës. Përkundër ekzistimit dhe garantimit juridik të këtyre të drejtave të njeriut, jemi dëshmitar se në përditshmërinë e njeriut shkelen në mënyrë flagrante këto të drejta, njerëzit për shkak të frikës dhe pasigurisë, nuk reagojnë dhe heqin dorë nga të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me kushtetute dhe norma ndërkombëtare.

### **3. Ndalimi i skllavërisë dhe praktikave të ngjashëm me skllavërinë**

Ndalimi i skllavërisë është një ndër angazhimet e par ndërkombëtare të shteteve në kuadër të të drejtave të njeriut. Lufta për ndalimin e skllavërisë është zhvilluar paralelisht brenda shteteve dhe në nivel ndërkombëtare. Si institucion skllavëria për së pari herë është ndaluar në Francë me një ligj të miratuar më 1971. Pas shembullit të Francës e ndjekim edhe Danimarka në vitin 1802, pastaj Anglia në vitin 1807 në të gjitha dominionet e saj. Holanda ndaloi trafikun e skllavëve më 1814, Spanja më 1820, duke ndjekur Portugalinë në vitin 1815. Grupin e fundit të shteteve që e suprimuan skllavërinë ishin SHBA-të, të cilat e kishin ndaluar trafikun e skllavëve më 1808, por kjo praktikë vazhdoi deri në përfundimin e Luftës Civile, kur skllavëria definitivisht suprimohet më 22 shtator të vitit 1862.<sup>42</sup>

Tregtia me skllavëri cenonte rëndë integritetin fizik dhe qenësor të njeriut, zotësinë e ekzistimit të njeriut si qenie njerëzore, subjektivitetin e ti tij juridik, e cila është një parakusht themelore për të pasur statusin e subjektit të së drejtës, ky që është *conditio sine qua non* për gëzimin e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Pra, skllavi nuk gëzonte asnjë të drejtë njerëzore.

<sup>42</sup> Më tepër shih në: Gruda, Z. (2001). Mbrojta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Universiteti i Prishtinës, fq. 94-101

Në nenin 1 të Konventës kundër Skllavërisë dhe Protokollit shtesë të saj 1926, me skllavëri nënkupton: “gjendje e një personi ndaj të cilit ushtrohet ndonjë, ose të gjithë pushtetet e të drejtës së pronësisë”. Si forma të skllavërisë nënkuptohen ndër të tjera edhe rastet si vijojnë: trashëgimi i gruas së një të vdekuri nga trashëgimtarët e tij, e drejta e burrit, e familjes ose e fisit të tij që ta shesë atë, çdo institut ose praktikë me anë të së cilës një person i ri ose një fëmijë nën moshën 18 vjeç i jepet një personi tjetër nga njëri ose të dy prindërit ose nga kujdestari i tij, qoftë për kundrejt shpërblimit ose jo me qëllim shfrytëzimin e tij ose punës së tij, gjendja e personit i cili është i detyruar të punojë nën tokën e një tjetri që nuk është i lirë të ndryshojnë statusin e tij etj.<sup>43</sup>

Ndalimi i skllavërisë parashihet në nenin 4 të KEDNJ, nenin 8 paragrafi 1 të PNDCP dhe nenin 4 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut ku potencohet se: “Askush nuk duhet të mbahet në robëri ose detyrimisht i nënshtruar; robëria dhe tregtia me robër janë të ndaluara në të gjitha format”.<sup>44</sup> Nga pjesa e përcaktimit të skllavërisë vërejmë edhe përcaktimin e formave të tjera të skllavërisë që janë evidente në ditët e sodit si: prostitucioni dhe forma tjera të shfrytëzimit seksual, trafikimi i qenieve njerëzore, trafikimi i organeve njerëzore, skllavëria ose varësia e plotë ndaj borxheve, fëmijë ushtarë, martesë e vajzave në moshë të mitur etj. Të gjitha këto sot paraqiten si shqetësime për botën moderne.

Siç e vërejtëm më lartë, krahas ndalimit të skllavërisë, formave të ngjashme të skllavërisë, nenet e mësipërme ndalojnë edhe punën e detyruar me dhunë ose detyrim. Se çka konsiderohet punë e detyruar ose me dhunë, në këtë mes jepen praktika përkatëse gjyqësore.<sup>45</sup> Sipas KEDNJ neni 4, paragrafi 3, punë e detyruar nuk konsiderohet: “çdo lloj pune që i kërkohet të kryejë zakonisht një personi të ndaluar, respektivisht në kuadër të një dënimi penal; çdo lloj shërbimi i karakterit

<sup>43</sup> Për më tepër shih në nenin 1 të Konventës plotësuese të viti 1956. Supplementary Convention on the Abolition of Slavery, the Slave Trade, and Institutions and Practices Similar to Slavery. Adopted by a Conference of Plenipotentiaries convened by Economic and Social Council resolution 608(XXI) of 30 April 1956 and done at Geneva on 7 September 1956 Entry into force: 30 April 1957, in accordance with article 13

<sup>44</sup> Brownlie, I. (2009). *Basic Documents in International Law*. Oxford University Press, f. 193

<sup>45</sup> Në rastin Irves kundër Norvegjisë, 1963, Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut, nuk e konsideroi si punë të detyruar, por si pjesë në detyrimet normale të qytetarëve, dërgimin e mjekëve dhe mësuesve në zonat e thella malore për shkak të mungesës së një personeli të tillë.

ushtarak, ose çdo lloj shërbimi që kërkohet në rast krizash ose fatkeqësish, që kërcënojnë jetën ose mirëqenien e komunitetit; çdo lloj pune ose shërbimi që është pjesë e detyrimeve normale qytetare”.

### **Conclusion**

We can conclude that the right to life is a fundamental human right, because, without respecting this right, other human rights cannot be imagined. The right to life is a sublime and inevitable right. The right to life together with the right to protection of physical integrity has special importance in international human rights law. The Republic of Northern Macedonia is a signatory to all basic acts that protect human life and physical integrity and in the focus of the legal framework is fully harmonized with international human rights norms.

### **Recensentë:**

**Prof. dr. Nazmi Maliqi**

**Prof. dr. Afrim Osmani**

### **Literatura**

- PAKTI NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE, Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 2200 A (XXI) të datës 16 dhjetor 1966, HYRË NË FUQI: 23 mars 1976

- Konventa Evropiane për të Drejta dhe Liritë Themelore të Njeriut e miratuar në Romë më 04.10.1950, si dhe plotësuar me Protokollat bazë: shoqëruar nga Protokollat Nr. 1, 4, 6, 7, 12 e 13 dhe ndryshuar me Protokollat Nr. 11 dhe 14.

- Komiteti Evropian i të Drejtave të Njeriut, Koment i Përgjithshëm Nr. 6, UN Doc.HRI/GEN/1/Rev.6, (2003) paragrafi 6

- Komenti i Përgjithshëm i Komitetit të të Drejtave të Njeriut Nr. 32, UN Doc.CCPR/C/GC/32 (2007), para.59. *Shih Tibi v Ekuadorit* (Gjykata Ndër-Amerikane); shih, gjithashtu, *Maritza Urrutia v Guatemalës* (Gjykata Ndër-Amerikane); *Cantoral-Benavides k Perusë* (Gjykata Ndër-Amerikane); Komenti i Përgjithshëm Nr.6 i Komitetit të të Drejtave të Njeriut, HRI/GEN/1/Rev.6 at 127 (2003), para.16; *McLawrence v Xhamajkës* (Komiteti i të Drejtave të Njeriut)

- Raporti i Raportuesit Special për Ekzekutimet Ekstra-gjyqësore, të Jashtëzakonshme ose Arbitrare (2009), O.K.B Doc.A/HRC/11/2, paragrafi 29-42.
- Raporti i Raportuesit Special për Ekzekutimet Ekstra-gjyqësore, të Jashtëzakonshme ose Arbitrare, O.K.B Doc.A/HRC/8/3, para. 59-67
- Raporti i Raportuesit Special për Ekzekutimet Ekstragjyqësore, të Jashtëzakonshme ose Arbitrare (2005), UN Doc.E/CN.4/2005/7, parag.61
- *Boyce dhe Joseph v Mbretëreshës* (Këshilli Kofidencial), parag. 6. Shih gjithashtu Raportuesin Special për Ekzekutimet Ekstra-gjyqësore, të Jashtëzakonshme ose Arbitrare (2005), O.K.B. Doc.E/CN.4/2005/7, parag.63
- Raportuesi Special për Ekzekutimet Ekstragjyqësore, të Jashtëzakonshme ose Arbitrare (2005), OKB Doc.E/CN.4/2005/7, paragrafi 57 dhe 59.
- Brownlie, I. (2009). *Basic Documents in International Law*. Oxford University Press;
- Gomien, D. (2005). *Udhëzues i shkurtër u Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Këshilli i Evropës*. Gent Grafik. Tiranë, f. 20.
- Daci, J. (2011). *Të drejtat e njeriut*. Botimi III. Shtëpia botuese Julvin. Tiranë, fq. 245-251
- Slyne fon. (2016). *Zbatimi i të drejtave të njeriut në praktikë*. Londër, UK, fq. 91-101.
- Ligji për ndërprerjen e shtatzënisë së Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare RM nr. 87 nga viti 2013.
- Sinani, D. (2012). *Përkufizimi juridik i vdekjes. Eutanazia*. Shtëpia botuese Naimi, Tiranë.
- Gomien, D. (2005). *Udhëzues i shkurtër i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*. Këshilli i Evropës. Gent Grafik. Tiranë, f. 21.
- Gruda, Z. (2001). *Mbrojta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut*. Universiteti i Prishtinës, fq. 94-101
- Supplementary Convention on the Abolition of Slavery, the Slave Trade, and Institutions and Practices Similar to Slavery. Adopted by a Conference of Plenipotentiaries convened by Economic and Social Council resolution 608(XXI) of 30 April 1956 and done at Geneva on 7 September 1956 Entry into force: 30 April 1957, in accordance with article 13.